



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media

Mbledhja nr.33

Prishtinë, më 19 shtator 2018, në orën:10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Shqipe Pantina, Jasmina Zhivković, Valon Ramadani, Adem Mikullovi, Imet Rrahmani, Arban Abrashi, Xhevahire Izmaqi, Rasim Selmanaj, Milaim Zeka dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje mori pjesë: Ministri i MAP-së, z. Mahir Yagcilar dhe përfaqësues nga IKAP.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit;**
- 3. Shqyrtimi i Projektligjit për Aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA);**
- 4. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2017;**
- 5. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit

Shqipe Pantina pati vërejtje që në procesverbale nuk shënohet emri i deputetit, kur votohet kundër apo për, ose mendimi ndryshe.

Me këtë vërejtje që kjo të inkorporohet në procesverbalet vijuese, procesverbalet u miratuan.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)

Nait Hasani njoftoi komisionin se sipas Marrëveshjes ReSPA, të vitit 2007/2008, Kosova është vetëm vëzhguese në Shkollën e ReSPA-së, të cilët e përfaqësojnë vendet e Evropës juglindore, ndërsa që me këtë P/ligji Kosova fiton të drejtën e aderimit në Shkollën e ReSPA.

Shqipe Pantina propozoi që P/ligji duhet të miratohet, pasi që në këtë shkollë trajnimi i shërbyesve civil do të ndikon në reformimin e tyre dhe ngritjen e cilësisë së punës së tyre. Ndërsa sa i përket ndryshimit të titullit dhe nenit të marrëveshjes, ajo tha se çështjet teknike të marrëveshjes i takojnë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Valon Ramadani tha se nuk pajtohet me miratimin e P/ligjit, pasi që marrëveshja i referohet Rezolutës 1244.

Mahir Yagcilar sqaroi se marrëveshja nuk është e nënshkruar nga UNMIK-u, gjithashtu nuk e ka as stemën e Republikës së Kosovës, për arsye se kjo marrëveshje është e nënshkruar nga vendet anëtare para Pavarësisë së Kosovës. Nga atëherë Kosova ka rolin e vëzhguesit, ndërsa me P/ligj Kosova aderon në shkollën ReSPA, me seli në Mal të Zi – Danillovgrad. Ai theksoi se mos miratimi i P/ligjit do të ndikojë që Kosova të humbi jo vetëm buxhetin i cili është ndarë për trajnimet e shërbyesve civilë me qëllim të reformimit të administratës publike, por edhe statusin e vëzhguesit dhe kjo çështje kthehet në pikën zero.

Komisioni me shumicë votash “Për”, 1 “Kundër” - Valon Ramadani dhe 1 “Abstenim” – Adem Mikullovc, votoi për P/ligjin dhe nxori këtë,

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Projektligji nr. 06/L-099/1, për Aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA).
2. Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, propozoi këto amendamente si vijon:

Amendamenti 1

Titulli i projektligjit ndryshohet si në vijim: “**Projektligji për Aderimin e Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)**”.

Amendamenti 2

Neni 1, riformulohet si vijon: “**Qëllimi i këtij ligji është aderimi i Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike (ReSPA)**”.

3. Arsyetimin e raportit në Kuvend do ta paraqesë deputeti, Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetim

Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 19.09.2018, shqyrtoi Projektligjin nr. 06/L-099/1, për Aderimin e Kosovës në Marrëveshjen për themelimin e Shkollës Rajonale të Administratës Publike (ReSPA). Pasi qëllimi i këtij projektligji është aderimi i Kosovës në Shkollën Rajonale të Administratës Publike, Komisioni rekomandoi që Projektligjin ta procedojë për miratim në Kuvend

4. Shqyrtimi i Raportit për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2017

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në bazë të nenit 67 dhe 72, të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19.09.2018, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2017, dhe vendosi që Kuvendit t’ia paraqet këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet Raporti vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2017.
2. Arsyetimin e Raportit me rekomandime e paraqet, deputeti Nait Hasani, kryetar i komisionit.

Arsyetimi

Në bazë të nenit 6.1, të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës i raporton Kuvendit të paktën një herë në vit për gjendjen në shërbimin civil.

Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, në mbledhjen e mbajtur më 19.09.2018, shqyrtoi Raportin vjetor mbi gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, për vitin 2017 dhe vlerësoi se Raporti vjetor i punës është në pajtim me nenin 6 të Ligjit për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kuvendit i rekomandon miratimin e tij.

Mbledhja përfundoi në orën:11:15.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetari i komisionit,

Nait Hasani